

IMPACT OF GOVERNMENT MEASURES TO PREVENT COVID-19 ON BUDGET REVENUES IN THE REPUBLIC OF KOSOVO

Vehbi Imeri

College Biznesi, Prishtina, Kosovo, vehbi.imeri@hotmail.com

Shyqeri Kabashi

College Biznesi, Prishtina, Kosovo, kbiznesi@gmail.com

Abstract: This paper is designed to present a scientific analysis regarding the impact of government measures to prevent COVID-19 on Budget Revenues of the Republic of Kosovo, measures applied by the Government of the Republic of Kosovo to prevent the spread of the COVID-19 Pandemic have had direct effects on the Budget Revenues of the Republic of Kosovo and in all their types. The effects of these measures were reflected by reducing it to the cessation of activities in many areas, most affected were the areas of services related to passenger transport, both land and air, the closure of gastronomy and hotel activities, activities of animal and vehicle markets, sports and cultural activities, while on the other hand some facilities provided by the Ministry of Finance and Transfers for extension of the deadline for payment of property tax and personal and corporate income taxes, pension contributions such as Interim measures had a direct impact on the amount and timing of tax obligations, and finally the measures taken by the Central Bank of Kosovo to extend the loan repayment period for both businesses and individuals, these circumstances have brought difficult position have forced the Government and the same to increase public debt to cover public spending. This paper will analyze whether these government measures to prevent the spread of the COVID-19 pandemic have had an impact on the decline in budget revenues.

Keywords: COVID-19 Pandemic, Measures, Taxes, Budget Revenues

NDIKIMI I MASAVE QEVERTARE PËR PARANDALIMIN E COVID-19 NË TË HYRAT BUXHETORE NË REPUBLIKËN E KOSOVËS

Vehbi Imeri

College Biznesi, Prishtina, Kosovo, vehbi.imeri@hotmail.com

Shyqeri Kabashi

College Biznesi, Prishtina, Kosovo, kbiznesi@gmail.com

Abstrakt: Ky punim është i hartuar me qëllim të paraqitjes së një analize shkencore lidhur me ndikimin e masave qeveritare për parandalimin e COVID-19 në të Hyrat Buxhetore të Republikës së Kosovës, masat e aplikuara nga Qeveria e Republikës së Kosovës për parandalimin e përhapjes së Pandemisë COVID-19 kanë pasur efekte direkte në të Hyrat Buxhetore të Republikës së Kosovës dhe ato në të gjitha llojet e tyre. Efektet e këtyre masave u reflektuan duke e reduktuar deri në ndërprerjen e aktiviteteve të shumë fushave, më së tepërmi u prekën fusha e shërbimeve që lidhen me transportin e udhëtarëve si ai tokësor ashtu edhe ai ajror, mbyllja e aktiviteteve të gastronomisë dhe hotelierisë, aktiviteteve të tregjeve të kafshëve dhe të automjeteve, aktiviteteve sportive e kulturore, ndërsa nga ana tjetër disa lehtësira të ofruara nga Ministria e Financave dhe e Transfereve për zgjatje të afatit të pagesës së tatimit në pronë dhe tatimeve në të ardhurat personale dhe të korporatave, kontributeve pensionale si masë e përkohëshme patën ndikim direkt në lartësinë dhe kohën e përmbushjes së detyrimeve tatimore, si dhe në fund masat e ndërmarra nga Banka Qendrore e Kosovës për zgjatjen e afatit të kthimit të kredive si për biznese ashtu edhe për individ, këto rrethana e kanë sjellë në pozitë të vështirë Qeverinë dhe të njejtën e kanë detyruar që për mbulimin e shpenzimeve publike të rrisë borxhin publik. Në këtë punim pra do të analizohet se a kanë pasur ndikim në rënjen e të hyrave buxhetore këto masa qeveritare për parandalimin e përhapjes së pandemisë COVID-19.

Fjalët kyqe: Pandemia COVID-19, Masat, Tatimet, Të Hyrat Buxhetore

1. HYRJE

Muaji Mars 2020 e gjen Kosovën nën masat për parandalimin e pandemisë COVID-19 që përfshiu tërë globin, duke u gjetur nën këtë situatë Qeveria e Republikës së Kosovës sikurse edhe qeveritë e vendeve tjera ishte e shtërnguar të ndërmirte masa për parandalimin e përhapjes së kësaj pandemie vdekjeprurëse, andaj mbi këtë bazë vuri masat kufizuese të cilat patën efekte direkte në realizimin e të hyrave si të bizneseve ashtu edhe të individëve, mosrealizimi i të hyrave të bizneseve dhe individëve shkaktoi edhe rënjen e realizimit të të hyrave buxhetore.

Duke pasur parasysh se shtyerja e afatit të pagesës së tatimeve ka efekte direkte në lartësin e realizimit të të hyrave buxhetore, ku një mos realizim i paraparë i nivelit të paraparë, krijoi vështirësitë e para në pagesën e shpenzimeve publike pasi që të njëjtat paraqesin burimin kryesor të të hyrave publike.

Efektet e masave të ndërmarra nga Qeveria duke ndaluar ushtrimin e aktiviteteve biznesore, ku si pasojë bizneset nuk do të realizojnë të hyra, pasojat janë se ato ia zvogëlojnë fuqinë blerëse dhe paguese të obliguesit tatimor duke shkaktuar efekte të natyrës sociale, ekonomike, financiare dhe morale.

Për tejkalimin e kësaj situatë qeverisë iu imponua që për tejkalimin e kësaj situatë të gjej mënyra për të financuar deficitin e shkaktuar nga këto masa, andaj njëra prej mundësive që qeveria e vlerësoi ishte hyrja borxh, pra duke rritur borxhin publik.

Rritja e borxhit publik në njërin anë dhe në anën tjetër rënja e realizimit të planifikimit buxhetor të të hyrave që një faktor që ndikon në zhvillimin ekonomik të një vendi, pasiguria dhe duke mos pasur një qasje reale të situatës së krijuar, duke munguar një bashkërendim i përballimit të situatës së krijuar në mes të Qeverisë dhe Bizneseve mund të përfundoj me një kolaps ekonomik financiar, që për pasojë mund të kenë falimentimin e shumë bizneseve prej të cilave gjenerohet rritje e papunësisë, ulje drastike në pagesën e tatimeve dhe taksave, andaj për të përballuar këtë Qeverisë i duhet një bashkërendim i aktiviteteve Qeveri – Biznes që kanë për qëllim mirëqenjen shoqërore dhe ti shpëtojnë kollapsit ekonomik financiar.

Analiza e këtyre situatave të krijuara duke filluar nga rënja e trendit të realizimit të pagesave të tatimeve, dinamika e rritjes së borxhit publik, ndërprerja e aktiviteteve biznesore në fushat e transportit të udhëtarëve, gastronomisë dhe hotelierisë, tregjeve të hapura, aktivitetet sportive e kulturore, duke shkaktuar vështirësitë zingjirore prej rënjes së zhvillimit ekonomik, rritjes së papunësisë, rritjen e numrit të cilët duhet ti nënshtrohen asistencës sociale.

Studimi paraqet një analizë të parametrave financiar krahasues për periudhën e nëntë mujore raportuese dhe atë për vitet 2018, 2019 dhe 2020.

2. MASAT E APLIKUARA DHE FUSHAT NË TË CILAT KANË PASUR EFEKTE

Masat e Qeverisë së Republikës së Kosovës për parandalimin e përhapjes së Pandemisë COVID-19 më së tepërmi i prekën fushat e shërbimeve që lidhen me Transportin e udhëtarëve si ai tokësor ashtu edhe ai ajror (kjo masë ka goditur në mënyrë direkte të gjitha kompanit si ato private ashtu edhe ato publike që ushtronin këto aktivitete), mbyllja e kafiterive, bareve, pabeve dhe restoranteve, qendrave tregtare duke bërë përjashtim të farmacive dhe marketeve ushqimore (kjo masë ka goditur të gjitha kompanitë private që ushtronin këto aktivitete, si dhe fermerët), mbyllja e tregjeve të kafshëve dhe tregjeve të automjeteve (kjo masë ka goditur të gjitha kompanitë private që ushtronin këtë aktivitet, si dhe fermerët), Ministria e Financave dhe e Transfereve duke u ballafaquar me masat e ndërmarra nga Qeveria merr Vendim për Zgjatje të afatit të pagesës së tatimit në pronë, dhe tatimit në të ardhurat e korporatave, tatimit në të ardhurat personale, tatimi për personat jorezident dhe qiratë, ndërsa tatimi për lojrat e fatit nuk është në funksion (*për këtë lloj tatimi Qeveria e Republikës së Kosovës me ndalimin e ushtrimit të këtij lloji të aktivitetit biznesor, për të njëjtin nuk ka më arsye të mbledhjes së tij*) vërejtje: Jemi vendi i dytë në Rajon që e ka ndaluar këtë aktivitet (Shqipëria dhe Kosova), andaj duke pasur parasysh periudhat krahasuese të Hyrat Buxhetore për vitin 2018, 2019 me atë të vitit 2020 referuar shënimeve të marrura nga Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) po paraqesim në tabelën vijuese

Përshkrimi	2018	2019	2020	Ndryshimi (2020/2019)
	në miliona Euro			
1. GJITHSEJ PRANIMET	1,509.67	1,676.33	1,502.25	-10%
1.1 Të hyrat buxhetore	1,289.91	1,379.34	1,215.21	-12%
1.1.1 Të hyrat tatimore	1,152.07	1,222.04	1,078.88	-12%
1.1.1.1 Tatimet Direkte	197.66	219.91	194.61	-12%
Tatimi në të ardhurat e korporatave	63.21	72.71	64.81	-11%
Tatimi në të ardhurat personale	113.63	122.73	113.84	-7%
Tatimi në pronë	18.14	21.14	15.10	-29%
Tatime tjera direkte	2.69	3.33	0.88	-74%
1.1.1.2 Tatimet Indirekte	991.33	1,034.73	904.60	-13%
Tatimi mbi vlerën e shtuar TVSH	585.44	614.53	542.30	-12%
Detyrimi Doganor	88.58	95.16	72.16	-24%
Akcizat	316.65	322.37	288.43	-11%
Tatimet tjera indirekte	0.66	2.66	1.71	-36%
1.1.1.3 Kthimet Tatimore	(36.92)	(32.59)	(20.34)	-38%
1.1.2 Të hyrat jo-tatimore	137.85	157.31	126.34	-20%
Taksa, ngarkesa dhe tjera nga OB-të e Qeverisë Qendrore	79.07	89.48	68.80	-23%
Taksa, ngarkesa dhe tjera nga OB-të e Qeverisë Lokale	31.95	36.10	31.18	-14%
Taksa koncesionare	6.62	8.43	2.65	-69%
Renta minerare	19.17	22.02	22.21	0.9%
Të hyrat nga interesi (kthimi i kredive nga Ndermarrjet Publike)	1.04	1.27	1.50	18%
Mbështetje buxhetore dhe grantet	-	-	9.99	0%
1.2 Pranimet nga financimi	219.76	296.99	287.03	-3%
Huamarrja	102.86	132.91	218.03	64%
Huamarrja e jashtme	13.55	22.60	75.51	234%
<i>nga te cilat nënhuazimet nga NP</i>	<i>4.20</i>	<i>4.00</i>	<i>3.86</i>	<i>-4%</i>
Huamarrja e brendshme	89.31	110.31	142.52	29%
Kthimi i kredive (kryegjës) nga Ndermarrjet Publike	5.44	5.44	5.69	0%
Të hyrat e dedikuara	9.30	3.74	1.63	-57%
Fondet e likuidimit nga AKP	86.08	150.00	55.05	-63%
Financimi i njëhershëm nga FKPK	9.97	-	-	0%
Pranimet nga grantet e përcaktuara të donatorëve	6.11	4.90	6.64	35%

Tab. 1 (Raport nëntëmujor financiar – Ministria e Financave – Thesari i Kosovës, Shtator 2020 fq. 6)

Pas një analize krahasuese të periudhave të njejta ndërmjet viti 2020 dhe 2019 rezultojnë se në total kemi rënje të realizimit të të hyrave buxhetore dhe atë në periudhën e nëntëmujorit 2020 në raport me nëntëmujorin 2019 në shkallën prej - 10 %.

Nga kjo tabelë rezultojnë se kemi rritje të huamarrjes nga dy burime dhe atë nga huamarrja e jashtme kemi një rritje në shkallën prej 234 % si dhe nga huamarrja e brendshme kemi rritje në shkallë prej 29 %.

Të hyrat tatimore kanë pësuar rënje në shkallë prej 12 %.

Duke pasur parasysh se efektet e masave qeveritare për parandalimin e pandemisë COVID-19 ka prodhuar një krizë të thellë ekonomike duke goditur me ndërprerje të aktiviteteve ekonomike të kompanive dhe individëve duke iu shkaktuar rënje të të hyrave dhe me këtë duke u pamundësuar gjenerimi i tyre dhe krijimi i kushteve për të të mos pasur detyrime tatimore në vijim, andaj kjo ka shkaktuar edhe rritjen e shkallës së papunësisë, nga këto masa ka rezultuar se ndërprerja e aktiviteteve ekonomike ka pasur ndikim direkt në:

TVSH si ajo e cila gjenerohet nga qarkullimi i mallrave dhe shërbimeve brenda vendit ashtu edhe ajo e cila gjenerohet me rastin e importimit të mallrave përmes pagesës në import ka rënje në shkallë prej 12 %, ndërsa detyrimi doganor ka pësuar rënje në shkallë prej 24 % nga kjo mund të konkludojmë se kemi një rënje të importit.

Tatimi në pronë ka rënje në shkallë prej 29 %, Tatimi në të Ardhurat Personale kemi rënje në shkallë prej 7 %, ndërsa Tatimi në të Ardhurat Korporatave kemi rënje në shkallë prej 11 %, Tatimet tjera ku hynë Tatimi në Interes, Qira dhe Jo-Rezident ku sipas Vendimit të Qeverisë për ndalimin e lojrave të fatit ka pësuar rënje në shkallë më të theksuar prej 29 %.

3. STRUKTURA E TË HYRAVE BUXHETORE

Struktura e të hyrave buxhetore sipas burimeve të financimit (këto shënime janë marrë nga *Raport nëntëmujor financiar – Ministria e Financave – Thesari i Kosovës, Shtator 2020*.

3.1. Të hyrat nga doganat

Të hyrat nga doganat kanë pësuar një rënje të theksuar nga rënja e importit, andaj kjo rënje shihet në tabelën vijuese:
Të hyrat dhe kthimet nga Dogana e Kosovës për periudhën janar – shtator 2020

Llojet e të hyrave	2018	2019	2020	Ndryshimi (2020/2019)	Krahasim % (2020/2019)
	në miliona Euro				
Të hyrat bruto	836.97	864.14	749.46	(114.68)	-13%
TVSH	428.51	441.03	385.66	(55.37)	-13%
Tarifa doganore në import	88.58	95.16	72.16	(23.00)	-24%
Akciza në kufi	305.29	317.69	288.14	(29.56)	-9%
Akciza e brendshme	11.36	4.68	0.29	(4.39)	-94%
Tjera /1	3.23	5.57	3.22	(2.35)	-42%
Kthimet	-4.01	-1.46	-0.89	0.57	-39%
Kthimi i TVSH	-0.36	-0.64	-0.55	0.09	-13%
Kthimet tjera /2	-3.65	-0.82	-0.34	0.48	-59%
Të hyrat neto	832.96	862.68	748.57	(114.11)	-13%

/1 Kategoria tjera përfshin: tatimet e taksat tjera nga dogana, masat tjera antidamping, kundervajtje e denime doganore, te hyrat nga gjujkata e paspecifikuar, te hyrat nga shitja e mallrave, banderrolat, kontrollat e jashtme doganore, fast dogana.

/2 Kthimet tjera përfshijne: kthimet e akcizes, taksas doganore ne importe, dhe taksave tjera doganore.

Tab. 2 (Raport nëntëmujor financiar – Ministria e Financave – Thesari i Kosovës, Shtator 2020 fq. 9)

3.2. Të hyrat dhe kthimet nga Administrata Tatimore e Kosovës (ATK)

Të hyrat dhe kthimet nga ATK kanë pësuar një rënje të theksuar nga rënja e importit, andaj kjo rënje shihet në tabelën vijuese:

Të hyrat dhe kthimet nga ATK për periudhën janar – shtator 2020

Llojet e të hyrave	2018	2019	2020	Ndryshimi (2020/2019)	Krahasim % (2020/2019)
	në miliona Euro				
Të hyrat bruto	336.73	372.35	336.16	-36.18	-9.7%
TVSH /1	156.93	173.50	156.65	-16.86	-10%
Tatimi në të ardhurat e korporatave	63.27	72.71	64.81	-7.91	-11%
Tatimi në të ardhurat personale	113.63	122.74	113.84	-8.91	-7%
Të hyrat nga gjobat e ATK-së	2.63	3.10	0.85	-2.25	-72%
Të hyrat tjera të grumbulluara nga ATK /2	0.27	0.29	0.02	-0.26	-92%
Kthimet	(32.91)	(31.14)	(19.45)	11.69	-38%
Kthimi i TVSH - së	-29.51	-26.96	-18.74	8.21	-30%
Kthimet tjera /3	-3.40	-4.18	-0.70	3.48	-83%
Të hyrat neto	303.81	341.21	316.72	-24.49	-7.2%

Tab. 3 (Raport nëntëmujor financiar – Ministria e Financave – Thesari i Kosovës, Shtator 2020 fq. 10)

3.3. Të hyrat vetanake nga komunat

Të hyrat vetanake nga komunat kanë pësuar një rënje të theksuar nga rënja e importit, andaj kjo rënje shihet në tabelën vijuese:

Të hyrat e nivelit lokal (tatimore dhe jo tatimore)

Llojet e të hyrave	2018	2019	2020	Krahasim % (2020/2019)
	në miliona Euro			
1. Tatimore	18.14	21.14	15.10	-29%
Tatimi në Pronë	18.14	21.14	15.10	-29%
2. Jo-tatimore	31.95	36.10	31.18	-14%
Taksat komunale	19.98	23.21	21.68	-7%
Lejet dhe Licencat /1	0.83	0.59	0.38	-37%
Gjobat, denimet, konfiskimet dhe te hyrat nga inspektimi	0.83	0.59	0.38	-37%
Shitja e pasurisë/shërbimeve dhe të hyrat nga pasuria	1.50	1.76	1.26	-28%
Tjera /2	9.63	10.55	7.74	-27%
1. Gjithsej të hyrat e grumbulluara nga Komunat	0.00	0.00	0.13	0%

/1 Përfshin: Licencat ne sektorin e naftës, te hyrat nga burimet natyrore (lejet).

/2 Përfshin: Të hyrat nga tatimet dhe tarifatat për vednimet gjyqësore përmbartimor.

Tab. 4 (Raport nëntëmujor financiar – Ministria e Financave – Thesari i Kosovës, Shtator 2020 fq. 11)

3.4. Të hyrat nga huamarrjet e jashtme dhe të brendshme

Të hyrat nga huamarrjet kanë pasuar një rritje të theksuar, pranimet nga huamarrja kanë arritur vlerën prej 218.03 milionë euro duke përfshirë pranimet nga nën-huazimet të pranuar në emër të shërbimit të borxhit ndërkombëtar. Krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak realizimi është më ilartë për 85.12 milionë euro, si pasojë e nevojës për financim të deficitit të shkaktuar, përkatësisht nga emetimi i letrave me vlerë, gjithashtu në rritje të pranimeve nga financimi kanë ndikuar edhe të hyrat nga fondet e likuidimit nga AKP, andaj kjo rritje shihet në tabelën vijuese:

1.2 Pranimet nga financimi	219.76	296.99	287.03	-3%
Huamarrja	102.86	132.91	218.03	64%
Huamarrja e jashtme	13.55	22.60	75.51	234%
<i>nga te cilat nën-huazimet nga NP</i>	4.20	4.00	3.86	-4%
Huamarrja e brendshme	89.31	110.31	142.52	29%
Kthimi i kredive (kryegjës) nga Ndermarrjet Publike	5.44	5.44	5.69	0%
Të hyrat e dedikuara	9.30	3.74	1.63	-57%
Fondet e likuidimit nga AKP	86.08	150.00	55.05	-63%
Financimi i njëhershëm nga FKPK	9.97	-	-	0%
Pranimet nga grantet e përcaktuara të donatorëve	6.11	4.90	6.64	35%

Tab. 5 (Raport nëntëmujor financiar – Ministria e Financave – Thesari i Kosovës, Shtator 2020 fq. 6)

Faktorët që ndikuan në rënjen e të hyrave buxhetore dhe rritjes së huamarrjes janë:

- Masat e qeverisë për ndalimin përkatësisht kufizimin e ushtrimit të aktiviteteve të ekonomike të kompanive dhe individëve në fushat e Transportit të udhëtarëve si ai tokësor ashtu edhe ai ajror, mbyllja e kafiterive, bareve, pabeve dhe restoranteve, qendrave tregtare duke bërë përjashtim të farmacive dhe marketeve ushqimore, mbyllja e tregjeve të kafshëve dhe tregjeve të automjeteve,
- Rënja e realizimit të të hyrave pas ndalimit përkatësisht kufizimit të aktiviteteve ekonomike që ka ndikuar në uljen e inkasimit të tatimeve dhe ulja e tatimeve ndikoi në uljen e të hyrave buxhetore,
- Rënja e papunësisë edhe pse qeveria në mënyrë indirekte përmes një pakos emergjente me një ndihmë prej një vlere të pagës minimale për dy muaj ka mbështetur bizneset e prekura nga masat e marra,
- Rritja e numrit të përfituesëve të asistencës sociale,
- Mungesa e mjeteve financiar për mbulimin e shpenzimeve (të dalurave) publike, paraqiti nevojën e huamarrjes nga dy burime.

Rekomandimet për tejkalimin e situatës së krijuar:

- Qeveria për çdo masë që duhet të mirret të rrisë bashkëpunimin dhe bashkëbisedimin me përfaqësuesit e bizneseve dhe Odave Ekonomike,
- Dhënja e mundësisë së bizneseve që përmes zbatimit të masave për parandalimin e përhapjes së pandemisë COVID-19 të ushtrojnë aktivitetet ekonomike, por jo të bëhet ndalimi total i ushtrimit të aktiviteteve të tyre,
- Hartimi i planit të veprimit qeveritar duke përfshirë të gjithë masat parandaluese duke mos ndaluar ushtrimin e aktiviteteve ekonomike,
- Hartimi i platformës për rimëkëmbje ekonomike, për hartimin e të cilës duhet të marrin pjesë të gjithë duke filluar prej qeverisë, bizneset, ekspertë të të gjitha fushave dhe shoqëria civile.

REFERENCAT

- Anessi-Pessina, E., Barbera, C., Langella, C., Manes-Rossi, F., Sancino, A., Sicilia, M., & Steccolini, I. (2020). Reconsidering public budgeting after the COVID-19 outbreak: key lessons and future challenges. *Journal of Public Budgeting, Accounting & Financial Management*.
- Brewer, M., & Gardiner, L. (2020). The initial impact of COVID-19 and policy responses on household incomes. *Oxford Review of Economic Policy*, 36(Supplement_1), S187-S199.
- Maher, C. S., Hoang, T., & Hindery, A. (2020). Fiscal Responses to COVID-19: Evidence from Local Governments and Nonprofits. *Public Administration Review*.
- Nicola, M., Alsafi, Z., Sohrabi, C., Kerwan, A., Al-Jabir, A., Iosifidis, C., ... & Agha, R. (2020). The socio-economic implications of the coronavirus pandemic (COVID-19): A review. *International journal of surgery (London, England)*, 78, 185.
- Ozili, P. K., & Arun, T. (2020). Spillover of COVID-19: impact on the Global Economy. Available at SSRN 3562570.
- Raport nëntëmujor financiar (2020). Ministria e Financave – Thesari i Kosovës